



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

Fushë Kosovë , data 03.06.2026

**THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIM TË AKTIVITETEVE TË ORGANIZATAVE TË
SHOQËRISË CIVILE QË KANË PËR QËLLIMË RRITJEN E NIVELIT TË PUNËSIMIT TË
ANËTARËVE TË KOMUNITETIT JOSHUMICË**

UDHËZIME PËR APLIKUESIT

Data kur hapet thirrja: 03.06.2026

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit: 23.05.2026

Përmbajtja

1. Thirrje publike për mbështetjen financiare të projekteve/programeve të OJQ-ëve	2
1.1 Problemet që synohet të zgjidhen përmes kësaj thirrjeje publike	Error!
Bookmark not defined.	
1.2 Qëllimet e projektit	3
1.3 Vlerat e planifikuara të mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes.....	3
2. <u>2. Kushtet formale të thirrjes publike</u>	5
2.1 Aplikuesit e pranuar: Kush mund të aplikoj?.....	5
2.2 Partnerët në zbatimin e projektit	5
2.3 Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme.....	6
2.4 Shpenzimet e papranueshme	6
3. <u>3. Si duhet të aplikojmë</u>	8
3.1 Lista e dokumenteve të nevojshme	Error! Bookmark not defined.
3.2 Formulari i propozimit të projektit	8
3.3 Formulari për propozimin e buxhetit.....	8
3.4 Dorëzimi i aplikacionit	9
3.5 Afati për dorëzimin e aplikacionit	9
3.6 Si do të na kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?.....	9
4. <u>4. Vlerësimi i aplikacionit</u>	10
4.1 Aplikacionet e pranuar do ta kalojnë këtë procedurë.....	10
4.2 Shpallja e vendimit preliminar.....	12
4.3 Dokumentet shtesë.....	12
4. <u>5. Kalendari indikativ i përfundimit (realizimi) i thirrjes</u>	12
5. <u>6. Ankesat</u>	13
6. <u>7. Lista e formularëve</u>	13

THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIMIN E AKTIVITETEVE TË SEKTORIT TË OJQ-ve QË KANË PËR QËLLIMË RRITJEN E NIVELIT TË PUNËSIMIT TË ANËTARËVE TË KOMUNITETIT JOSHUMICË

03.06.2026

Ky thirrje publike për dorëzimin e propozimeve të projekteve nga organizatat e shoqërisë civile është e orientuar drejt forcimit të pozitës socio-ekonomike të anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, përmes mbështetjes së iniciativave që kontribuojnë në integrimin e tyre aktiv në tregun e punës dhe përmirësimin e aftësive dhe punësueshmërisë së tyre.

1. Qëllimet e projektit

Organizatat e shoqërisë civile në përputhje me këtë thirrje publike mund të dorëzojnë aplikime me projekte në fushat e tyre prioritare, si më poshtë:

Kontributi në punësim, angazhimin në praktikë dhe organizimin e trajnimeve me theks të veçantë tek gratë, të rinjtë, personat me aftësi të veçanta si dhe grupet e tjera të marginalizuara brenda komuniteteve jo-shumicë që jetojnë në Kosovë.

Në përputhje me këtë thirrje publike, OJQ-të mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat e mëposhtme prioritare:

1. Angazhimi i praktikantëve për kryerjen e praktikës në institucione dhe organizata të ndryshme;
2. Organizimi i trajnimit për aftësitë e buta(soft skills);
3. Rrjetëzimi profesional;
4. Trajnim për zanate të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në trajnime për parukierë, rrobaqepës, marangozë, mekanikë makinash etj., si dhe punësimin e praktikantëve në këto punë.
5. Me zbatimin e projektit duhet të përfshihen të gjitha rajonet në Kosovë.

1.1 Organizatat mund të aplikojnë me maksimumi 1 projekt në këtë thirrje.

Periudha e zbatimit të projektit është tre muaj.

Gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit, aplikuesi duhet të sigurojë që ato të bazohen në parimin e mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, si dhe të zhvillojë aktivitete në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

1.2 Vlerat e planifikuara të mbështetjes financiare për projektet dhe vlera total

- Shuma totale e këtij thirrjeje është 500.000 euro dhe shuma minimale e maksimale për të cilën aplikanti mund të aplikojë është deri në shumën maksimale të kësaj thirrjeje. Njëkohësisht, kjo shumë mund të rritet ose të ndryshohet në përputhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe numrin e aplikimeve.
- Projektet mund të financohen deri në 100% të shpenzimeve të pranueshme të projektit (7% është shuma maksimale e lejuar për shpenzimet administrative të aplikantëve).
- Shuma minimale që një praktikant gjatë trajnimit mund të marrë si kompensim në nivel mujor është 500 euro (pagë minimale e përcaktuar me ligj).
- Me këtë thirrje është paraparë angazhimi i minimum 300 praktikantëve për kryerjen e praktikës në institucione dhe organizata të ndryshme.
- Gjatë procesit që lidhet me praktikantët, Ministria, brenda kapaciteteve të saj institucionale dhe administrative, gjatë thirrjes publike do të pranojë edhe aplikimet e praktikantëve të dorëzuara nga kandidatët e interesuar.

Prioriteti i kësaj thirrjeje u jepet OJQ-ve që jo vetëm punojnë për komunitetin, por kanë edhe zyra në të gjitha rajonet e Kosovës.

2. Kushtet formale të thirrjes publike

2.1 Aplikuesit e pranuar: Kush mund të aplikojë?

Për pranimin e kësaj thirrjeje, organizata aplikante duhet të:

- Të jetë e regjistruar në përputhje me Ligjin për lirinë e bashkimit në organizatat joqeveritare,
- Të ketë numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës,
- Të disponojë me kapacitete ligjore, financiare dhe të punës për zbatimin e projektit,
- Të ketë përvojë dhe veprimtari në fushën e zhvillimit shoqëror-ekonomik dhe fusha të tjera të përshtatshme me këtë thirrje për propozime,
- Të ketë paguar të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet e tjera të detyrueshme, ose të jetë në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
- Të mos jetë në proces falimentimi, mbylljeje apo likuidimi;
- Të mos ketë shkelur kushtet e përdorimit të mjeteve publike financiare,
- Të mos ketë marrë mjete financiare për të njëjtën veprimtari gjatë këtij viti (kërkohet deklaratë për shmangien e financimit të dyfishtë),
- Të ketë dorëzuar propozimin e projektit sipas formularit të aplikimit të projektit/programit së bashku me formularin e buxhetit.

2.2 Kriteria të veçanta

Që aplikimi të konsiderohet plotësisht i kompletuar, aplikanti duhet të plotësojë kriteret minimale të veçanta të parashikuara nga dispozitat e mëposhtme:

- Dorëzojë propozimin e projektit brenda afatit të thirrjes, me të dhëna për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, afatin e zbatimit, rezultatet, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhëna të tjera sipas formatit përkatës të përcaktuar në thirrjen publike.
- Bashkëngjisë propozimin e buxhetit sipas formatit të përcaktuar.
- Dorëzojë të dhëna për personelin kyç, detyrat e tyre, CV-të dhe pranimin e tyre për të punuar në projekt në rast marrjes së mbështetjes financiare nëse është e nevojshme sipas ftesës.
- Në rast bashkëfinancimi duhet të sigurohen dëshmi përkatëse për projektet ku zbatohet bashkëfinancimi.
- Në rastin kur kërkohet bashkë me ligj, aplikanti duhet të dorëzojë leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë, në rastet kur sipas ligjeve në fuqi kryerja e një veprimtarie mund të bëhet vetëm me leje/licencë të lëshuar nga organet shtetërore.
- Dëshmi se në tre vitet e fundit ka pasur projekte të ngjashme ose të njëjta dhe se në bazë vjetore në tre vitet e fundit, ka pasur të paktën 400,000 euro.

OJQ-të që nuk mund të aplikojnë

OJQ-të që nuk i kanë plotësuar kriteret e përmendura më sipër nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare ose, në rast aplikimi, dosja e tyre nuk do të merret në konsideratë në fazën e shqyrtimit dhe nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

2.3 Partnerët në zbatimin e projektit

Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë për mbështetje financiare të projekteve të tyre në kuadër të partneritetit me OJQ të tjera. Në rastin e propozimit për zbatimin e projekteve në partneritet me OJQ, duhet të dorëzohet aplikacioni për partneritet.

Duhet të merret parasysh kërkesa formale e përcaktuar në formularin 12 të Udhëzimit të MF nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Partneriteti përfshin marrëdhënie ndërmjet OJQ-ve që nënkuptojnë përgjegjësi për zbatimin e programeve-projekteve të financuara nga ofruesit e mbështetjes financiare. Për të siguruar zbatimin pa pengesa të programit-projektit, të gjitha organizatat që janë pjesë e partneritetit duhet të respektojnë praktikatat e mira të partneritetit.

1. Para dorëzimit të aplikacionit të ofruesit të mbështetjes financiare, të gjithë partnerët do të lexojnë tekstin e thirrjes publike dhe udhëzimet për dorëzimin e aplikacionit dhe do të kuptojnë rolin e tyre në projekt ose
2. Të gjithë partnerët autorizojnë aplikantin që t'i përfaqësojë në të gjitha marrëdhëniet me MKK në kontekstin e zbatimit të projektit/programit.

3. Aplikuesi dhe të gjitha organizatat partnere takohen rregullisht dhe punojnë së bashku në zbatimin e programit ose projektit, vlerësojnë dhe shqyrtojnë mënyrat për të kapërcyer sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e projektit.
4. Të gjithë partnerët do të marrin pjesë në përgatitjen e raporteve të përbashkëta përshkruese dhe të veçanta financiare, dhe aplikanti në emër të të gjithë partnerëve i dorëzon ato te MKK.
5. Propozimet për ndryshime me partnerët e projektit duhet të bëhen me marrëveshje ndërmjet partnerëve, dhe aplikanti e dorëzon atë te ofruesi i mbështetjes financiare.

2.4 Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme

2.4.1 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes publike

Nga mjetet publike të këtij thirrjeje publike mund të financohen vetëm shpenzimet reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, brenda periudhës kohore të përcaktuar me këtë udhëzim. Në vlerësimin e projektit/programit do të merren parasysh vetëm shpenzimet e nevojshme në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe shuma reale e këtyre shpenzimeve.

2.4.2 Shpenzimet e pranueshme direkte

Shpenzimet sipas shpenzimeve të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e aktiviteteve të caktuara të projektit ose programit, siç janë:

1. Shpenzimet për materiale për realizimin e projektit;
2. Shërbime grafike (përgatitja për shtyp, shërbime shtypi për fletëpalosje, broshura, revista etj., me specifikimin e llojit dhe qëllimit të shërbimit, sasisë, çmimit për njësi etj.);
3. Shërbime reklamimi (prezantime televizive dhe radio, mirëmbajtja e faqeve të internetit, reklama në gazeta, materiale promovuese etj., përcaktimi i llojit të promovimit, kohëzgjatjes dhe çmimit të shërbimeve);
4. Shpenzime për përfaqësim në lidhje me organizimin e aktiviteteve të projektit/programit (me specifikimin e qëllimit dhe numrit të pritur të pjesëmarrësve etj.);
5. Shpenzime për paga dhe pagesa për drejtuesit e projektit/programit, kompensime për praktikantë, realizues të projekteve nga organizata dhe/ose partnerë të jashtëm të përfshirë në projekt (kontrata për të drejta autoriale dhe pasurore, kontrata të tjera, kontrata pune), me specifikimin e emrave të personave të angazhuar, kompetencave të tyre profesionale, numrit të muajve të angazhimit dhe shumës bruto mujore të kompensimit;
6. Shpenzimet derivuese nuk duhet të kalojnë më shumë se 5% të shumës totale të projektit të përfunduar;
7. Shpenzimet e paparashikuara nuk duhet të kalojnë më shumë se 5% të shumës totale të financimit të projektit.

2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë, si p.sh.:

1. Investime në kapital ose kredi investuese, fondet e garancisë;
2. Shpenzimet për blerjen e pajisjeve, mobiljeve dhe punimeve të vogla ndërtimore që tejkalojnë shumën prej 10% të totalit të pranueshëm të projektit;

3. Shpenzimet e interesave mbi borxhin;
4. Gjoha, dënime financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;
5. Pagesat e bonuseve për të punësuarit;
6. Detyrimet bankare për hapjen dhe menaxhimin e llogarive, tarifat për transferet financiare dhe tarifa të tjera të natyrës krejtësisht financiare;
7. Shpenzimet që tashmë financohen nga fondet publike ose shpenzimet gjatë periudhës së projektit që financohen nga burime të tjera;
8. Blerja e pajisjeve, makinerive dhe mobiljeve të përdorura;
9. Shpenzimet që nuk janë të përfshira në kontratë (kontratë me ofruesin e mbështetjes financiare);
10. Donacione bamirësie;
11. Kreditë për organizata të tjera ose për individë;
12. Shpenzime të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

2.4.4 Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të kualifikuara për financim:

- Aktivitetet që lidhen vetëm ose kryesisht me pjesëmarrjen individuale në seminare, konferenca dhe kongrese, si dhe punë kërkimore;
- Aktivitetet që lidhen vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose punëtori;
- Aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve;
- Aktivitetet ku përfituesit e vetëm janë anëtarët e OJQ-së aplikante.

2.4.5 Lista e llojeve kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes thirrjes publike

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është maksimumi tre (3) muaj;
2. Aktivitetet e projektit duhet të realizohen në territorin e Kosovës.

2.4.6 Lista e llojeve kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes thirrjes publike:

- Aktivitetet që lidhen me angazhimin e praktikantëve përmes investimit në trajnim dhe fitimin e njohurive të nevojshme për përfshirje në tregun e punës, ku prioritet do të kenë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të veçanta, si dhe grupet e tjera të marginalizuara brenda komuniteteve jo-shumicë;
- Aktivitetet që lidhen me organizimin e trajnimeve që do të promovojnë, zhvillojnë dhe ndërtojnë kapacitetet e komuniteteve për t'u bërë konkurruese në tregun e punës, si dhe për t'i pajisur me njohuritë e nevojshme që të jenë të aftë për punë dhe mundësi të reja punësimi;
- Aktivitetet që lidhen me krijimin e një rrjeti profesional ku do të ofrohet organizimi i aktiviteteve të përbashkëta të anëtarëve të rrjetit dhe do të mund të shkëmbehen informacione mbi mundësitë e punësimit ose trajnimit, si dhe ndihma e ndërsjellë në zgjidhjen e problemeve që lidhen me punën;
- Vëmendje e shtuar ndaj çështjeve që lidhen me gratë nga komunitetet (p.sh., nivele më të larta të përfshirjes së grave në punësim, praktikë dhe trajnim);

- Aktivitetet që kanë për qëllim përmirësimin e politikave qeveritare në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve në lidhje me punësimin;
- Aktivitetet për zhvillimin e mundësive ekonomike për komunitetet dhe/ose anëtarët e komuniteteve jo-shumicë, pra aftësimin e tyre për krijimin e të ardhurave në cilindo sektor.

3. Si të aplikojmë ?

Lista e dokumenteve të nevojshme

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjithë formularët dhe anekset detyruese siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si më poshtë:

1. Formulari i propozimit të ofertës
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i Deklaratës së Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
4. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-ve;
5. Kopje e certifikatës së numrit fiskal;
6. Formulari i deklaratës për mungesë financimi të dyfishtë;
7. Formulari i aplikimit për projekte ose programe të OJQ-ve që financohen nga burimet e financimit publik;
8. Formulari i deklaratës për aktivitetet e përshkruara të programit/projektit;
9. Deklarata vjetore për vitin 2023, 2024, 2025 (nga ATK);
10. Vërtetim i Administratës Tatimore të Kosovës për gjendjen e borxhit publik, i vlefshëm në datën e dorëzimit të aplikacionit (jo më i vjetër se 30 ditë), i cili vërteton se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të papaguara apo detyrime të tjera tatimore, ose se është në marrëveshje për ta shlyer borxhin me ATK;
11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të dorëzojë dëshmi se OJQ-ja dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim për vepra penale;
12. Vërtetim nga banka për llogarinë aktive të organizatës joqeveritare para nënshkrimit të kontratës.

Propozimet do të dorëzohen vetëm me formularët e kërkuar, të cilët së bashku me Udhëzimet për aplikantët janë të disponueshëm në web faqen e MKK-ës.

3.1 Formulari I propozimit të projektit

Plotësimi i formularit të projekt-propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ai përmban informacione për aplikuesin dhe partnerët, si dhe informacione për përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burime publike. Në rast se formularit të dorëzuar i mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret parasysh. Formulari duhet të plotësohet me kompjuter. Nëse formulari plotësohet me dorë, ato nuk do të merren parasysh. Nëse formulari i përshkrimit përmban defekte siç u përmend më lart, aplikacioni do të konsiderohet i pavlefshëm.

Ky formular duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar dhe të vuloset.

3.2 Formulari për propozimin e buxhetit

Formulari i propozim-buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozimi buxhetor i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projekt-programit të propozuar për financim. Nëse formulari i buxhetit nuk është plotësuar plotësisht, ose nuk dorëzohet në formularin përkatës, aplikimi nuk do të merret parasysh. Formulari duhet të plotësohet në kompjuter. Nëse formulari plotësohet me dorë, nuk do të merret parasysh.

Ky formular duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar dhe të vuloset.

3.3 Dorëzimi i aplikimit

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në arkivin e MKK-së në formë të printuar (me CD, materiale shtesë/projekte grupore).

Aplikimet dorëzohen në një zarf të mbyllur, ku në zarf vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm original, si dhe një kopje elektronike në një CD. Në pjesën e jashtme të zarfit shkruani emrin e ftesës publike, me emrin dhe mbiemrin e plotë, adresën e aplikantit, me shënimin "*Mos e hapni përpara seancës së Komisionit të Vlerësimit*" dhe shkruani në zarf thirrjen publike.

Dokumentet e kompletuara dërgohen me postë ose personalisht në adresën e mëposhtme:

Ministria për Komunitete dhe Kthim , rr. Nëna Terezë, PN. 12000 Fushë Kosovë / Kosovë Zyra e arkivit
--

Për mbështetje financiare do të konsiderohen vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të përcaktuar me këtë thirrje publike dhe që i kanë plotësuar kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

3.4 Afati për dorëzimin e aplikacionit

Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve në MKK është data 23.06.2026, deri në orën 16:00. Aplikuesit i lëshohet një konfirmim se aplikacioni është pranuar gjatë periudhës së konkurrimit. Të gjitha aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

3.5 Si do të na kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen ekskluzivisht në mënyrë elektronike në adresën e mëposhtme: request.mkk.mpz.mcr@rks-gov.net jo më vonë se 10.06.2026. Përgjigjet do të kthehen në format elektronik dhe do të publikohen në faqen zyrtare të MKK-ës deri më 17.06.2026.

Për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët e mundshëm, ofruesi i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një opinion paraprak për pranueshmërinë e aplikantëve, partnerëve, veprimeve ose shpenzimeve të specifikuara në kërkesë.

4. Vlerësimi i aplikacionit

4.1 Aplikacionet e pranura do ta kalojnë këtë procedurë

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në përputhje me kërkesat e **Rregullores MF- nr. - 04/2017** për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. MKK do të themelojë një komision vlerësues në përputhje me rregulloren, detyra e të cilit është të vlerësojë nëse aplikacionet i përmbushin kërkesat formale të thirrjes publike.

- Në fazën e parë vlerësimi do të bëhet nga aspekti procedural. Pas kontrollit të të gjitha aplikacioneve të pranura, komisioni do të përgatisë listën e të gjithë aplikantëve që plotësojnë kërkesat për vlerësimin e përmbajtjes së projekteve të tyre, si dhe listën e aplikantëve që nuk i plotësojnë kërkesat. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët e pakualifikuar dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.
- Në fazën e dytë, vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve do të bëhet nga Komisioni i Vlerësimit. Çdo aplikim i pranuar do të vlerësohet në përputhje me rregulloren dhe formularin e vlerësimit (shih më poshtë).
- Faza thelbësore (2) aplikantët e parakualifikuar mund të ftohen të paraqesin propozime për projekte,
- faza e nënshkrimit të kontratës,
- faza e zbatimit,
- Raporti përfundimtar

Formulari për vlerësim					
Kriteret e vlerësimit ndahen në disa fusha vlerësimi. Në çdo fushë vlerësimi, pikat ndërmjet (1) dhe (5) janë caktuar, në përputhje me kategoritë e vlerësimit më poshtë. 1 = i pamjaftueshëm, 2 = i mjaftueshëm, 3 = i mirë, 4 = shumë i mirë, 5 = i shkëlqyer.					
A. Kapacitetet institucionale të organizatës (25 pikë)					
Kapacitetet profesionale dhe përvoja e organizatës dhe organizatave partnere (nëse ka) për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit	1	2	3	4	5
Kapaciteti i menaxhimit të projektit dhe struktura e organizatave dhe organizatave partnere (nëse ka) të tilla si: stafi, pajisjet dhe aftësia për të menaxhuar buxhetin e projektit.	1	2	3	4	5
Përvoja dhe njohuritë e stafit dhe ekspertëve, (CV) të organizatës zbatuese të projektit	1	2	3	4	5
Strukturë e qartë për menaxhimin e projektit dhe ndarjen e përgjegjësi, detyrimeve të anëtarëve të ekipit	1	2	3	4	5

Angazhimi i grupeve të marginalizuara (gratë, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, komunitetet) ose vullnetarëve në zbatimin ose aktivitetet e projektit	1	2	3	4	5
B. Rëndësia e projektit (40 pikë)					
Rëndësia e projektit për qëllimet, synimet dhe fushat prioritare të thirrjes	1	2	3	4	5
Përcaktimi i qartë i qëllimeve të projektit që janë realiste për t'u arritur	1	2	3	4	5
Aktivitetet janë të qarta, efikase, të arsyetuara, të kuptueshme dhe të zbatueshme	1	2	3	4	5
Përcaktimi i qartë i rezultateve dhe lidhja e aktiviteteve me rezultate specifike	1	2	3	4	5
Identifikimi i qartë i përfituesve të projektit dhe aktiviteteve që synohen në mënyrë efektive për përfituesit	1	2	3	4	5
Identifikimi dhe angazhimi i akterëve përkatës në zbatimin e projektit dhe arritjen e rezultateve	1	2	3	4	5
Projekti përcaktoi qartë nevojat dhe mënyrën se si adresohen nevojat përmes aktiviteteve	1	2	3	4	5
Janë parashikuar rreziqe të mundshme dhe hapa për të shmangur rreziqet	1	2	3	4	5
C. Shpenzimet dhe buxheti (20 pikë)					
Shpenzimet e projektit janë në përputhje me rezultatet që pritet të arrijë projekti	1	2	3	4	5
Shpenzimet e projektit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara	1	2	3	4	5
Shpenzimet e projektit janë të arsyetuara dhe të bazuara në çmimet e tregut	1	2	3	4	5
Shpenzimet e projektit janë reale me kohëzgjatjen e pritshme të projektit	1	2	3	4	5
D. Ndikimi i projektit (15 pikë)					
Projekti është inovativ dhe kreativ për të arritur qëllimet	1	2	3	4	5
Projekti ndikon në situatën e përgjithshme në zonën në të cilën po zbatohet	1	2	3	4	5
Rezultatet e projektit janë të qëndrueshme	1	2	3	4	5
GJITHSEJT	100 Pikë				

4.2 Shpallja e vendimit preliminar

Pas përfundimit të vlerësimit, rezultatet paraprake të vlerësimit shpallen si vendim në faqen e MKK-së dhe të gjithë fituesit njoftohen me shkrim.

Rezultatet paraprake shndërrohen në rezultate përfundimtare nëse nuk paraqitet ndonjë ankesë brenda afatit të caktuar. Nëse paraqitet ndonjë ankesë, rezultatet paraprake bëhen rezultate përfundimtare pas zgjidhjes së ankesave të aplikuesve.

Të gjithë aplikuesit, aplikimet e të cilëve janë përfshirë në procedurën e vlerësimit, do të njoftohen për vendimin për dhënien e projekteve në kuadër të thirrjes.

4.3 Dokumentet shtesë

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, MKK-ja do ta kërkojë nga aplikuesi dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë dëshmi se OJQ-ja dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim penal;

Komisioni vlerësues do të shqyrtojë dokumentacionin shtesë. Nëse aplikuesi nuk e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm shtesë brenda afatit të caktuar, jo më pak se 10 ditë, kërkesa do të refuzohet. Nëse, pas kontrollit të dokumenteve shoqëruese, vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të thirrjes publike, ata nuk do të konsiderohen për nënshkrimin e kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen pasi të kontrollohen dokumentet mbështetëse dhe pasi institucioni t'i konfirmojë se ka fonde të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë një listë përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim që kanë hyrë në listën e ngushtë.

5. Kalendari indikativ i përfundimit (realizimi) të thirrjes

03.06.2026 -	Hapja e thirrjes
10.06.2026 -	Afati për paraqitjen e pyetjeve në lidhje me thirrjen
17.06.2026 -	Publikimi i përgjigjeve në faqen e MKK-së
23.06.2026 -	Afati për dorëzimin e projekt propozimeve në MKK
26.06.2026 -	Publikimi i rezultateve paraprake, njoftimi i aplikuesve
30.06.2026 -	Afati i fundit për paraqitjen e ankesave
03.07.2026 -	Vendim i Komisionit të Ankesave
06.07.2026-	Nënshkrimi i kontratës

Finansuesi ka të drejtë ta përditësojë kalendarin indikativ . Çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në ueb faqen e MKK-së.

Periudha dhe shtrirja gjeografike e zbatimit të projektit

Periudha e zbatimit të projektit është indikative nga 06.07.2026 - 30.09.2026. Projektet mund të zbatohen në të gjitha komunat e Kosovës

6. Ankesat

Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave, aplikuesit mund të bëjnë ankesë pranë Komisionit të Ankesave si më poshtë:

- Ankesa kundër vendimit për përjashtim për shkak të mosplotësimit të kriterëve formale gjatë vlerësimit të kërkesës në aspektin procedural dhe
- Ankesa kundër vendimit për dhënien ose mosdhënien e mbështetjes financiare.

Të gjitha ankesat lidhur me ftesën publike duhet të dorëzohen në arkivin e MKK-së në kopje fizike nga aplikuesi ose personi i tij i autorizuar jo më vonë se 30.06.2026. Në përputhje me Rregulloren, Komisioni i Ankesave do të marrë vendim me datën 03.07.2026.

7. Lista e formularëve

Lista e formularëve të kërkuar të parashikuar nga rregullorja dhe manuali për zbatimin e projektit:

1. Formulari i projekt propozimit
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i Deklaratës së Partneritetit (nëse aplikohet)
4. Formulari i deklaratës për mungesë financimi të dyfishtë;
5. Formulari i deklaratës së projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet e financimit publik.
6. Formulari i deklaratës për aktivitetet e përshkruara të programit/projektit;